

Në bazë të nenit 18, paragrafi (1), nënparagrafi 22, nenit 20, paragrafi (1), nënparagrafi 10¹ dhe neni 24 të Ligjit të Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr.42/20, 77/21, 154/23, 55/24, 193/24 dhe 247/25), dhe në lidhje me nenin 41 nga Ligji i njëjtë, neni 39, paragrafët (2) dhe (3) nga Ligji i Procedurës së Përgjithshme Administrative ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.124/15), neni 15, paragrafi (1), nënparagrafi 23, neni 41, paragrafi (1), nënparagrafi 8 dhe nenin 60, paragrafi (4) të Rregullores së Punës së Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele nr.01-3632/1 të datës 22.08.2025, duke vepruar sipas Njoftimit për ndryshimin e strukturës pronësore të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive 24 VESTI ShPKNJ P Shtip PA1 nr.02-132 të datës 13.05.2026, në pajtim me Konkluzionin nr.ark.02-2697/2 të datës 09.07.2026, Këshilli i Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele gjatë seancës së 25.-të të mbajtur më 09.07.2026, miratoi:

AKTVENDIM
për refuzimin e Njoftimit për ndryshimin e strukturës pronësore të
Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive 24 VESTI ShPKNJ P Shtip

1. Njoftimi për ndryshimin e strukturës pronësore të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive 24 VESTI ShPKNJ P Shtip, PA1 nr.02-132 të datës 13.05.2026, refuzohet për shkak se është i paplotë dhe i paqartë, përkatësisht nuk përmban të dhëna të sakta, të plota dhe reciprokisht konsistentë nga regjistrat publikë kompetent, në mënyrë që të mund të inicohet vendimmarrje e mëtejshme.

2. Aktvendimi do publikohet në faqen e internetit të Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele.

3. Ky aktvendim është përfundimtar.

A r s y e t i m e

Drejtuar Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele (Agjencia) më 13.05.2026, ShTR VESTI ShPKNJ P Shtip, dorëzoi Njoftim për ndryshimin e strukturës pronësore (nr.y në PA1 02-132 të datës 13.05.2026), me shtojcë të gjendjes vijuese të transmetuesit, të lëshuar nga Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë së Veriut (RQRMV) më 12.05.2026. Sipas të dhënave të përfshira në gjendja vijuese, u konstatua se pronar i vetëm i ShTR 24 VESTI ShPKNJ P Shtip është personi juridik KOMNET 328 ShPK Beograd, me seli në rr. "Vladimir Popović" nr. 28-9, Beograd, Republika e Serbisë.

Gjatë procedurës, Agjencia ka kryer mbikëqyrjen e të dhënave publike të dorëzuar nga regjistri që mbahet nga Agjencia e Regjistrave të Biznesit të Republikës së Serbisë (ARBR), ku është regjistruar ky person juridik, dhe u përcaktua se: me datë 13.02.2026, ndaj personit juridik KOMNET 328 ShPK Beograd është inicuar procedurë për likuidim të detyrueshme dhe se të njëjtën ditë (13.02.2026), është publikuar njoftim për likuidim të detyruar i njëjtë person juridik, dhe më 27.04.2026 është miratuar Aktvendim për refuzimin e kërkesës që KOMNET 328 ShPK Beograd ka paraqitur më 24.04.2026, e cila i referohet ndryshimit "të të dhënave personale të personave të regjistruar".

Me qëllim përcaktimin e plotë të gjendjes faktike dhe sigurimin e të gjitha të dhënave të nevojshme për veprim ligjor, të saktë dhe objektiv sipas Njoftimit të paraqitur, dhe bazuar në nenin 41, paragrafi (4) të Ligjit të Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele (LSHMAAV), Agjencia ka vazhduar afatin për veprim në kohë shtesë prej 30 ditësh, për të cilën me shkresën nr.02-132 të datës 08.06.2026, u njoftua transmetuesin - ShTR 24 VESTI ShPKNJ P Shtip.

Agjencia, me datë 11.06.2026, ka kërkuar nga transmetuesi të paraqesë informacion në lidhje me fazën e procedurës për likuidimin e detyruar të personit juridik "KOMNET 328 ShPK Beograd – NË LIKUIDIM TË DETYRUAR", si dhe informacion mbi personin e emëruar si likuidator. Për sa më sipër ShTR 24 VESTI ShPKNJ

¹ Nënparagrafët 8 dhe 9 fshihen, shih: nenin 8 nga Ligji i ndryshimit dhe plotësimit të Ligjit të Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.248/18).

Shtip, me datë 24.06.2026, dorëzoi dokument – “Çertifikatë për regjistrimin e subjekti tregtar”, të lëshuar nga ARBRS, nga ku figuron se emri i plotë i subjektit juridik është KOMNET 328 ShPK Beograd – NË LIKUIDIM TË DETYRUAR, si dhe se përfaqësuesi ligjor (statutor) është personi fizik Zoran Kish. Megjithatë, transmetuesi dhe në afatin shtesë të caktuar nga Agjencia, nuk e plotësoi dhe ndryshoi Njoftimin e dorëzuar të ndryshimit të strukturës pronësore në mënyrën që do të paraqiste një dokumentacion të rregullt me shpjegim të duhur me të dhëna të sakta, të plota dhe reciprokisht të qëndrueshme nga regjistrat publikë kompetentë.

Nga sa më sipër, është e padiskutueshme se dokumentacioni mbi bazën e të cilit është paraqitur Njoftimi nuk pasqyron gjendjen aktuale faktike që ekzistonte në kohën e paraqitjes së tij. Konkretisht, Njoftimi iu dorëzua Agjencisë më 13.05.2026, përkatësisht pothuajse tre muaj pas fillimit (inicimit) të procedurës për likuidimin e detyruar të personit juridik KOMNET 328 ShPK Beograd në Republikën e Serbisë.

Nga të dhënat zyrtare të ARBRS-së rrjedh se në kohën e dorëzimit të Njoftimit, personi juridik ishte regjistruar tashmë me emrin “KOMNET 328 ShPK Beograd – NË LIKUIDIM TË DETYRUAR”, përkatësisht se ndryshimi në statusin e tij ligjor ishte regjistruar tashmë në regjistrin publik kompetent. Në të kundërtën, Statusi aktual i lëshuar nga RQRMV, i cili i ishte bashkëngjitur Njoftimit, e regjistron personin juridik me emrin e tij të mëparshëm, pa treguar se ndaj tij është inicuar procedurë likuidimi e detyruar.

Prandaj, u përcaktua se të dhënat e përfshira në dokumentacionin e paraqitur me Njoftimin nuk korrespondojnë me të dhënat e përfshira në ARBRS, si shteti në të cilin është regjistruar mbajtësi i pjesës pronësore, sepse përcaktimi „në likuidim të detyruar“ nuk përfaqëson vetëm ndryshim formal ose teknik në emrin e personit juridik, por përkundrazi tregon një status të ndryshuar juridik të subjektit i cili është i rëndësishëm për qasjen në procesin e vendimmarrjes.

Duke marrë parasysh, se në pajtim me nenin 41 të LShMAAV, procedura për miratimin e vendimit që do të lejojë ose ndalojë zbatimin e ndryshimit të strukturës pronësore duhet të kryehet në bazë të të dhënave të sakta, të plota dhe të harmonizuara reciprokisht dhe në pajtim me nenin 39, paragrafi (2) nga Ligji i Procedurës së Përgjithshme Administrative, parashtresa duhet të jetë mjaftueshëm e qartë për t'i mundësuar organit publik të ndërmarrë veprimin e kërkuar dhe në rastin konkret, Njoftimi i paraqitur nuk ofron një bazë të tillë faktike. Këshilli i Agjencisë në seancën e 25-të të mbajtur më 09.07.2026, në pajtim me Konkluzionin nr.ark.02-2697/2 të datës 09.07.2026, miratoi aktvendimin si në dispozitiv. Aktvendimi është përfundimtar dhe kundër këtij aktvendimi mund të ngrihet padi, për iniciimin e kontestit administrativ pranë gjykatës kompetente, në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit. Aktvendimi do të publikohet në faqen e internetit të Agjencisë.

**Agjencia e Shërbimeve Mediatike
Audio dhe Audiovizuale
Kryetari i Këshillit,
mr. Sasho Stefanovski d.v.**

Këshillë juridike: Ky aktvendim është përfundimtar, kundër këtij aktvendimi, transmetuesi ka të drejtë të ngrejë padi për iniciimin e kontestit administrativ pranë gjykatës kompetente. Padia për iniciimin e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.

Përktheu: Antoneta Shabani